



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 46/09

Prishtinë, më 18.03.2009, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Safete Hadërgjonaj, Müfera Şinik, Besa Gaxherri, Hajdin Abazi.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Shkumbin Demaliaj, Naser Osmani.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: **Lars Lage Olofsson Auditor Gjeneral dhe Qerkin Morina zv. Auditor nga ZAGJ-ja, Ilaz Duli kryetar i KRRPP-së, Hysni Hoxha kryetar i OSHP-së, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI, ICO, gazetar nga RTK, RTV21, RROKUM.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 11 mars 2009**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditorit Gjeneral për të hyrat dhe shpenzimet e Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2007**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik për vitin 2008**
- 5. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008**
- 6. Te ndryshme.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 11 mars 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 11 mars 2009, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditorit Gjeneral (ZAGJ) për të hyrat dhe shpenzimet e Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2007

Kryesuesi, theksoi se lidhur me raportin në fjalë ka pasur biseda me ish Auditoren Gjenerale, së cilës ia ka shprehur vërejtjet e veta dhe ka shpresuar se në raportin përfundimtar do të ketë korrigjime. Është konsideruar ndër raportet më të mira dhe shembull për institucionet tjera. Ndërsa pas leximit të tij tregon se si nuk duhet hartuar raportet e tilla. Raport është i hartuar për vitin 2007 ndërsa flet për aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2008.

Lars Lage Olofsson, u prezantua dhe tregoi përvojat e tija profesionale në fushën e auditimit. Theksoi se shpreson në bashkëpunimin me këtë komision dhe institucionet tjera përgjegjëse në realizimin e detyrave që parashtrihen para zyrës së auditorit gjeneral.

Qerkin Morina, theksoi se pasiqë auditori i kontaktuar nga RTK ka bërë një auditim më të plotë, është vlerësuar se tri auditime brenda vitit janë të panevojshme, prandaj ZAGJ-ja ka bërë një auditim të pjesshëm (të hyrat dhe shpenzimet). Sa i përket çështjes së ndryshimit të raportit pas kërkesës së kryetarit, atë nuk kanë mundur ta bëjnë sepse ishte publikuar. Ekipi që ka bërë auditimin ka pasqyruar të gjitha të shpenzimet që janë bërë konform vendimeve dhe rregulloreve të nxjerrur nga bordi udhëheqës. Se a kanë qenë këto akte në përputhje me kornizën ligjore, theksoi se nuk është i sigurt. Nuk përjashtoi mundësin për ndonjë lëshim, por se ato nuk janë të qëllimshme. Për detalet e raportit nuk ka informacione të mjaftueshme. Z. Morina premtoi se ZAGJ-ja në muajin prill do të fillojë auditimi i plotë të pasqyrave financiare të RTK-së për vitin 2008 dhe raportin e hartuar do t'ia dërgoj Kuvendit.

Kryesuesi, lidhur me auditorin e kontaktuar, theksoi se ai është dashur të jetë ndihmesë për punën e ZAGJ-së. Ndër të metat e këtij raporti është konstatimi joreal se RTK ka realizuar të hyra nga marketingu vetëm 1.500.000€ kur dihet se sa të hyra realizohen nga marketingu. Po ashtu ndër çështjet tjera jo të analizuar është edhe kontrata e RTK-së me një kompani për marketing e cila vazhdon që gjashtë vite për të kryer shërbime dhe nga auditorët nuk ka pasur analizë kritike për realizimin e kësaj kontrate, për kushtet e ripërtëritjes së saj, për monopolin që ka krijuar ajo.

Besa Gaxherri, duke u ndërlidhur me çështjen theksoi se raporti nuk e ka relevancën për tu diskutuar dhe si i tillë është jocilësor. Në raport ndër të tjera thuhet se është e mundur që informatat shtesë mund të kenë ekzistuar e nuk janë ofruar auditorëve, që lenë për tu kuptuar se nuk ka pasur liri në qasjen e gjithë dokumentacionit, prandaj edhe konstatimet për të gjeturat nuk mund të konsiderohen të qëndrueshme dhe reale. Prandaj kërkoi që ky medium publik të jetë më i përgjegjshëm në respektimin e ligjit. Gjithashtu edhe Zyra e Auditorit Gjeneral të jetë më korrekte në raportimet e veta.

Hajdin Abazi, konsideroi raportin shumë të mangët. Theksoi se është sakdaloze pamundësie për qasje në dokumentet zyrtare. Sikundër edhe ekzistimi i pesë llogari kryesore dhe dy nënllogarive. RTK-ja është e pavarur në politikën editoriale por jo edhe në aspektin financiar sepse shfrytëzon paranë publike, prandaj sikurse çdo institucion tjetër edhe ajo duhet dhënë llogari dhe nënshtrohet kontrollit agjencioneve kompetente. Edhe pse raporti është i vonshëm, nuk duhet lejuar të heshtën

parregullsitë. Duke ditur faktin se auditorët nuk kanë pasur qasje të mjaftueshme në të gjitha dokumentacionet, konstatimet për të gjeturat nuk mund të konsiderohen të besueshme.

Xhevdet Neziraj, theksoi se në raport janë paraqitur të hyrat nga parapagimi, nga marketingu dhe të hyra tjera, por nuk kemi material shtesë për të konstatuar se sa janë të sakta ato. Auditimi nuk duhet konsideruar një kontroll rigoroz por se nga ai duhet mësuar se si po menaxhohet paraja publike. Prandaj kërkoi që kjo zyrë të jetë më serioze në raportimet e tyre.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se si komision kemi bërë përpjekje që ZAGJ-ja të ketë kushte më të mira për punë, me shpresë se do të kemi punë më serioze dhe profesionale nga kjo zyrë, gjë që nuk po dëshmon ky raport që po shqyrtojmë. Vërejtjet e saja kishin të bënin me atë se në rekomandimet për të gjeturat nuk ceket se cili nen i ligjit është shkelur. Pastaj ekzistimi i llogarive dhe nënllogarive tregon shmangien e procedurave të pagesave përmes Thesarit. Në çështjen e pagave dhe mëditjeve shifet se auditorit nuk i ka interesuar si janë paguar punëtorët me kontratën mbi veprën. Menaxhmenti ka punuar pa ndonjë plan të prokurimit, ndërsa auditorit nuk ka bërë një analizë për shqyrtimin e lëndëve të prokurimit. Përmendi edhe rastin e marrëveshjes së RTK-së me një shkollë dizajni, për të trajnuar një punëtor, i cili megjithatë nuk ka ndjekur trajnimet, ndërsa menaxhmenti RTK-së për këtë trajnim ka paguar shpenzimet kësaj shkolle për tri vite.

Haki Shatri, konsideroi raportin të vjetruar dhe sipërfaqësor. Si rezultat i kësaj nuk ofrohen argumente për diskutim për gjendjen financiare në RTK në periudhën e caktuar. Shifrat e prezantuara për të hyrat dhe shpenzimet janë vetëm të bartura ashtu siç i kanë marrë pa një analizë kritike. Si Komision të kërkojmë që ZAGJ-ja të bëjë auditimin për vitin 2008 i cili i përmbush nevojat e raportimit dhe të sjell në Kuvend për shqyrtim.

Myrvete Pantina, gjithashtu vlerësoi raportin të mangët. Theksoi se nuk paraqiten të dhëna me vështrim kritik për të hyrat dhe shpenzimet, por se ato vetëm janë prezantuar siç janë pranuar. Nga raporti shifet se pjesën më të madhe e përbejnë shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe për paga, ndërsa nuk kemi një analizë për nivelin dhe kategorizimin e pagave. Vërejtje bëri edhe për mos analizimin e të ardhurave nga marketingu, për mos trajnimin e zyrtarit të prokurimit dhe si mosfunksionalizimi i auditorit të brendshëm.

Riza Smaka, u pajtua me konstatimet se raporti është sipërfaqësor. Në këtë raport janë bërë vetëm konstatime për të gjeturat dhe jo propozime për ndërmarrjen e masave ndëshkuese. Në raport shkruhet se ekziston 177 kontaktor dhe nuk kemi sqarime kush janë ata, në qfarë baze ligjore funksionojnë. Vërjepte bëri edhe për mungesën e shërbimit të rregullt juridik. Pagat shumë të larta në krahasim me periudhën paraprake, mëditjet e bordit po ashtu të larta. Shpenzimet kontaktuese marramendëse, ndërsa për shpenzimet e hotelit nuk jepen sqarime. Z. Smaka pyeti se a keni analizuar se a ka obligim ky institucion ndaj tyre ishpunëtorëve të RTP-së. Përndryshe raportin e konsideroj të pa pranuar.

Lars Lage Olofsson, vlerësoi kërkesat e komisionit për punë të frytshme nga ZAGJ-së, dhe në këtë drejtim do të duhej definoheshin rolet institucioneve përkatëse qeverisëse dhe secila në kuadër të përgjegjësi të jap kontributin, që të jemi të suksesshëm në punën tonë në kontrollin e menaxhimit të parasë publike.

Kryesuesi, konstatoi se nga diskutimet shifet se raporti ka shumë të meta dhe pa një analizë kritike për rekomandimet e dhëna. Të gjitha këto tregojnë se ky raporti është sipërfaqësor dhe vërë dyshimet se është i porositur dhe si të tillë nuk mund të rekomandojm për diskutim në Kuvend. ZAGJ-ja nuk ka për detyrë vetëm konstatimin e gjendjes, por përcjelljen e realizimit të të gjeturave. Nëse vërehen shkelje të rënda duhet drejtuar organeve ndjekëse. Prandaj kërkoi që kjo zyrë të bëjë një auditim

gjithëpërfshirës për pasqyrat financiare të RTK-së për 2008, dhe të njëjtin ta sjell për shqyrtim në Kuvend.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni konstatoi se Raporti i Zyrës së Auditorit Gjeneral për të hyrat dhe shpenzimet e Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2007 është sipërfaqësor dhe nuk përmbush kushtet ligjore për auditim dhe raportim, dhe si i tillë është i vonuar.
 - II. Komisioni i rekomandon Zyrës së Auditorit Gjeneral që të bëjë auditimin e plotë të pasqyrave financiare të RTK-në për vitin 2008 dhe raportin e hartuar ta dërgojë për shqyrtim në Kuvend.
- 4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik për vitin 2008**

Kryesuesi, theksoi se raporti përmbush kushtet për raportim. Megjithatë bëri vërejtje se prezantimi i shpenzimeve buxhetore është jo mjaftueshëm dhe nuk përmbush kushtet e përcaktuar me ligj.

Ilaz Duli, njofto se raporti është hartuar konform ligjit. Kemi prezantuar aktivitetet e prokurimit publik për vitin 2008 të realizuara nga autoritetet kontraktuese që i obligon ligji. Të dhënat ashtu siç janë pranuar nga të gjitha autoritetet kontraktuese. Nga raporti shifet se kemi pasur një evoluim të punëve të prokurimit publik në vitin 2008 në krahasim me periudhën paraprake. Është zvogëluar numri i kontratave me vlerë të madhe dhe është rritur i atyre me vlerë më të vogël, që bënë procedurën transparente në këtë drejtim. Nga këto kontrata 60% e tyre janë realizuar në bazë të afateve të rregullta, ndërsa 40% në bazë të afateve të shkurtuara. Konform ligjit kemi dhënë edhe rekomandimet tona për modifikimin e sistemit të prokurimit në të ardhmen.

Riza Smaka, vlerësoi raportin korrekt. Duke pasur parasysh faktin se keni rekomanduar për amendimin e ligjit, z.Smaka theksoi se ju jeni institucioni më kompetent që të identifikoni problemet që hasni në dispozitat e caktuara të ligjit dhe të bëni propozime konkrete për ndryshimin e tij, e mëpastaj Kuvendi t'i amendoj ato.

Myrvete Pantina, vlerësoi raportin të pasur me të dhëna. Shifet se gjatë monitorimit keni ardhur te disa konstatime. Pyeti cilat probleme i keni identifikuar në procedurat e prokurimit nga autoritetet kontraktuese.

Haki Shatri, theksoi se raporti i përmbush kriteret ligjore. Kërkoj sqarime lidhur me dy raste që janë përfshirë në raport. E para ka të bëjë me kontratën për pallatin e shtypit dhe rasti i dytë me kontratën e ndërtimit të objekti të Akademisë së Shkencave dhe Arteve. Siç dihet për këto dy projekte në buxhetin e vitit 2008 nuk janë paraparë mjete, gjithashtu as në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Kërkoj sqarime pse janë përfshirë në raport. Për aktivitetet e kryera në fushën OSHP-së deri në krijimin e tij është dashur të bëhet një marrëveshje që shënimet t'iu dërgoni atyre ose që të përfshijnë në raport. Përndryshe përkrahu raportin dhe rekomandimin për diskutim në Kuvend.

Besa Gaxherri, kërkoi disa sqarime për disa të dhëna që janë përfshirë. Pyeti pse ekziston numri kaq i madhë i kontratave me afate të shkurtra. Për kontratat mbi 3 milion € pse se nuk keni dhënë vërejtjet e juaja rreth realizimit të tyre. Vlerësoi rekomandimet e bëra për ndryshimin e ligjit, por theksoi se përmbajta e tyre do të duhej të ishte më ndryshe. Rasti i misioneve diplomatike, Qeveria

ka mundur të merr vendim që mos të jenë pengesë procedurat e prokurimit në konsolidimin e tyre. Po ashtu një rekomandim keni thënë të shikohet mundësia e mbrojtjes së menaxherit kontaktues, e q; në fakt si rekomandim do të duhej të ishte të shikohet mundësisë e përgjegjësive e tyre. Kjo tregon se nuk ka procedura transparente siç është thënë në raport. Urojë që trajnimet e zyrtarëve të jenë të mjaftueshme. Vërejtje bëri edhe për mosparaqitjen e detalizuara të shpenzimeve buxhetore për KRRPP-në për vitin paraprak.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se në rekomandimet e Komisionit Evropian është thënë se nuk ka bashkëpunim të mirë në mes KRRPP-së dhe Institutit në fushën e trajnime, andaj kërkoi sqarime për këtë çështje.

Kryesuesi, duke komentuar rekomandimet e KRRPP-së, theksoi se do të ishte zgjidhje më e mirë të hartohej një ligj i ri në të cilin do të shmangeshin këto pengesa që paraqet ligji ekzistues. Sidomos të rregullohen procedurat e prokurimit për misionet diplomatike dhe për ndërmarrjet publike. Ndërsa u shpreh i rezervuar me rekomandimin për thjeshtëzimin ligjit ekzistues dhe bartjen e disa pjesëve në legjislacionin dytësor. Praktika ka treguar se bartja e këtyre kompetencave ka ndikuar që të veprohet në kundërshtim me legjislacionin primar.

Kosara Nikolić, theksoi se në raport kemi të dhëna për aktivitetet e prokurimit edhe për vitin 2009, psh, rasti i KEK-ut kur flet për një kontratë që është nënshkruar në vitin 2008 dhe vazhdon edhe në vitin 2009. Kërkoi sqarime lidhur me këto.

Ilaz Duli, duke iu përgjigjur pyetjeve, theksoi se përkrahin idenë për hartimin e një ligji të ri. Lidhur me pyetjet për përfshirjen e kontratave që vazhdojnë edhe në vitin 2009, theksoi se neni 8.3 i ligjit lejon të nënshkruhen kontrata për 2 apo 3 vite, por se ekzekutimi i tyre brenda vitit bëhet sa ka buxhet ai autoritet publik për atë projekt. Ligji lejon edhe kontratat e rregullta por edhe ato me afate të shkurtuar. Për trajnime ende kemi nevojë. Materialet ia janë dërguar OSHP-së. Lidhur me procedurat më fleksibile të prokurimit për misionet diplomatike dhe ndërmarrjet publike kanë dhënë rekomandimet dhe përkrahin rregullimin e tyre me ligjin e ri. Arsyeja e dhënies së rekomandimeve për zvogëlimin e kontratave me vlera të vogla është bërë për shkak se praktika ka treguar se janë më të suksesshme. Në pyetjen për bashkëpunimin me institutin, rekomandimi është bërë kur nuk kemi lidhur kontaktet, ndërsa tani janë krijuar këto raporte.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni ka shqyrtuar Raportin e KRPP-së për aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2008, dhe ka konstatuar se i njëjti i plotëson standardet e raportimit, prandaj i propozon Kryesisë së Kuvendit ta radhisë në rend të ditës për shqyrtim në seancë plenare.
- II. Duke u bazuar në analizën e bërë raportit lidhur me mënyrën e implementimit të Ligjit për prokurimin publik, duke parasysh pengesat e shfaqura me procedurat e prokurimit publik në praktikë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të kërkoj nga Qeveria formimin e grupit punues për hartimin e Ligjit të ri për Prokurimin Publik i cili ndër të tjera duhet të përfshij:
 - Çështjet e prokurimit lidhur me Misionet diplomatike të Kosovës në vende të ndryshme të botës;
 - Rregullativën e cila do të rregulloj aktivitetet e prokurimit publik në sektorin e ndërmarrjeve publike duke u bazuar në Direktivën e BE-nr.2004/17.
- III. Prandaj është e domosdoshme që Kuvendi ta diskutoj për këtë çështje, siç theksohet në rekomandim.

5. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008

Kryesuesi, duke pasur parash kohën e veprimit të këtij organi mund të konstatojmë se raporti përmbush kushtet e raportimit. Megjithatë mënyra e paraqitjes së shpenzimeve është e papranueshme, do të duhej të dhëna më të detalizuara.

Haki Shatri, propozoi që të përkrahet raporti dhe të kërkohet që të plotësohet ai me pjesën financiare në bazë të formularëve standard në mënyrë që të jetë më i kompletuar për Kuvend.

Riza Smaka, theksoi se është dashur që në raport të ipen edhe propozimet për ndërmarrjen e masave ligjore ndaj shkelësve të procedurave të prokurimit në raport me rezultatin nga shqyrtimi ankesave.

Besa Gaxherri, theksoi se në raport është prezantuar vetëm problematika, ndërsa nuk keni bërë analiza se qfarë shkeljesh kanë ndodhur, cila organizatë buxhetore ka bërë shkelje më të shumta, në cilën fushë janë bërë ato, si dhe ndërmarrje e masave ndaj atyre shkelësve që janë konstatuar pas shqyrtimit të ankesave. Kërkoj që ky organ të jetë i pavarur dhe profesional në punën e vet.

Hysni Hoxha, në përgjigjen e pyetjeve, theksoi të metat që mund ti ketë raporti mund të jenë si rezultat i një përvoje të re dhe kohës së shkurtër të veprimit të këtij organi. Sa i përket vërejtjeve për ndërmarrjen e masave ndaj shkelësve që janë konstatuar pas shqyrtimit të ankesave, ligji i përcakton se autoriteti kontaktues duhet ekzekutoj ato, nëse ai nuk i bënë ato, atëherë ne jemi të obliguar të kërkojmë me një urdhëresë të shqiptohet dënimi për autoritetin kontaktues. Premtoi se do të dërgohet aneksi plotësues që jep detale më të shumta për shpenzimet buxhetore të OSHP-së për vitin paraprak.

Kryesuesi, raportoi ka disa vërejtje, sidomos në çështjen e masave ndaj shkelësve të procedurave, do të duhej të bëhej një analizë për shkeljet e neneve të ligjit në raport me ankesat si dhe propozimin e masave konkrete ndaj atyre që kanë shkelur procedurat e prokurimit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni ka shqyrtuar Raportin e OSHP-së për vitin 2008, dhe ka konstatuar se i njëjti i plotëson kushtet e raportimit, prandaj i propozon Kryesisë së Kuvendit ta radhisë në rend të ditës për shqyrtim në seancë plenare.
- II. Komisioni kërkon që para shqyrtimit të tij në Kuvend, raporti të plotësohet me një aneks plotësues financiar për shpenzimet buxhetore të OSHP-së për vitin 2008.
- III. Komisioni rekomandon OSHP-së që raportet e ardhshme vjetore të jenë më gjithëpërfshirëse. Të pasqyroheshin dispozitat e ligjit që janë shkelur në procedurat e prokurimit publik si dhe propozimin për ndërmarrjen e masave të caktuara ndaj këtyre shkelësve.
- IV. Prandaj është e domosdoshme që Kuvendi të diskutoj për këtë çështje, siç theksohet në rekomandim.

Mbledhja përfundoi në ora 13:15

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI